



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 12, datë 30.04.2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË Durrës PËR VITIN 2024**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e “Raportit mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Njësitë Administrative, Ndërmarrjet dhe Insitucionet e Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 02.05.2025

P.

**RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË
DURRËS PËR VITIN 2024**

Mars 2025



Përmbajtja

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	3
I. Shpenzimet sipas burimit të financimit	6
I.1 Shpenzimet nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	6
I.2 Shpenzimet nga Fondi i Rindërtimit.....	8
I.3 Shpenzimet nga transfertat e kushtëzuar	9
II. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	11
III. Karakteristika kryesore të performancës së shpenzimeve	15
Shpenzimet korrente.....	18
Shpenzimet kapitale.....	19
IV. Vetëvlerësimi financiar	21
V. Treguesit financiar	24
Shtojca 1: Fondi i rindërtimit nga buxheti i shtetit	26
Shtojca 2 : Realizimi i të ardhurave të veta për vitin 2024	48
Aneksi 1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"	60
Aneksi 2 "Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve"	61
Aneksi 5 "Projektet e investimeve me financim të brendshëm"	63



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Bashkia Durrës për vitin 2024 në mbështetje të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ka miratuar buxhetin të ndarë në 20 programe buxhetore. Plani fillestar i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024 i miratuar me VKB nr.195, datë 22.12.2023 ishte 4,514,104 mijë lekë. Në bazë të Vendimeve të veçanta të Këshillit Bashkiak buxheti u shtua në vlerën 817,658 mijë lekë. Këto shtesa përbëhen nga fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm 2023 në vlerën 665,182 mijë lekë, si dhe nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale që janë alokuar gjatë vitit në vlerën 152,476 mijë lekë.

Buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2024 (pa fondin e rindërtimit dhe fondet e ministrive të linjës) me të gjitha rialokimet e bëra kapi vlerën 5,331,761 mijë lekë. Po të shtojmë edhe transfertat e kushtëzuara (fondet e ministrive të linjës) që u alokuan gjatë vitit, si dhe fondet e rindërtimit, buxheti total i Bashkisë Durrës për vitin 2024 kapi vlerën 9,327,150 mijë lekë.

Për vitin 2024 të ardhurat e përgjithshme faktike janë 9,286,408 mijë lekë.

Të ardhurat e përgjithshme faktike nga gjitha burimet e financimit (të ardhurat e veta, transfertat e pakushtëzuara, transferta sektoriale, transfertat e kushtëzuara, fondet e rindërtimit, si dhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës) në fund të vitit 2024 rezultojnë 9,286,408 mijë lekë. Krahësuar me vitin 2023 janë 11% më pak. Kjo ulje vjen si rezultat i pakësimit të fondeve të alokuara në kuadër të procesit të rindërtimit nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit. Të ardhurat të ndara sipas burimit të financimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Të ardhurat sipas burimit për vitet 2023-2024 (në 000/lekë)


NR.	EMËRTIMI TË ARDHURAVE	Fakt 2023 000/lekë	Fakt 2024 000/lekë	Ndryshimi në %
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA (A1+A2+A3+A4)	1,851,571	2,303,708	24.4
A.1	Të ardhura nga taksat lokale	816,647	970,343	18.8
A.2	Të ardhura nga taksat e ndara	310,670	330,062	6.2
A.3	Të ardhura nga tarifatat vendore	594,721	825,615	38.8
A.4	Të ardhura të tjera	129,533	177,688	37.1
B	TRANSFERTA NGA BUXHETI QENDROR (B1+B2+B3)	7,021,490	4,303,778	-38.7
B.1	Transferta e pakushtëzuar	1,206,215	1,377,968	14.2
B.2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	689,665	744,161	7.9
B.3	Transferta e kushtëzuar (Ministritë e linjës)	1,526,845	1,471,166	-3.6
B.4	Fondi i rindërtimit	3,598,765	710,483	-80.3
C	HUAMARRJA (C1+C2)	-	-	-
C.1	Huamarrja afatshkurtër	-	-	-
C.2	Huamarrja afatgjatë	-	-	-
D	TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR (D1+D2)	1,572,051	2,678,922	70.4
D.1	Trashëgimi pa destinacion	593,805	816,737	37.5

NR.	EMËRTIMI TË ARDHURAVE	Fakt 2023 000/lekë	Fakt 2024 000/lekë	Ndryshimi në %
D.2	Trashëgimi me destinacion	71,072	48,450	-31.8
D.3	Trashëgimi nga fondi rindërtimit	907,174	1,813,740	100
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË (A+B+C+D)	10,445,112	9,286,408	-11

Të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2024, pa përfshirë fondet e trashëguara nga viti 2023, kapën vlerën **6,607,486 mijë lekë** dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet përbërja e tyre sipas peshës specifike që ato zënë.

Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitin 2024 janë 2,303,708 mijë lekë, me një realizim 98%. Gjatë vitit 2024 janë arkëtuar nga taksat dhe tarifat 19% më shumë se viti 2023. Në shtojcën 2 është paraqitur në mënyrë të detajuar realizimi i të ardhurave të veta të Bashkisë Durrës për vitin 2024.

Të ardhurat e arkëtuara viti 2024



Për vitin 2024 shpenzimet e përgjithshme faktike janë 6,870,439 mijë lekë.

Për vitin 2024 shpenzimet e përgjithshme faktike të Bashkisë Durrës nga të gjitha burimet e financimit, duke përfshirë edhe fondet e ministrive të linjës, si dhe fondet e rindërtimit nga buxheti i shtetit kapën vlerën 6,870,439 mijë lekë. Sipas burimit të financimit shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Durrës për vitin 2024 janë si në tabelën 2:

Tabela 2: Shpenzimet faktike për vitin 2024 në 000/lekë

Emërtimi shpenzimit	Totali	Burimi i Financimit				
		Të ardhurat e veta (grup 00-kapitull 5)	Transferrat e pakushtëzuar dhe sektoriale (grup 00-kapitull 1)	Të ardhura jashtë limit (grup 00-Kapitull 6)	Fondet e rindërtimit	Transferrat e kushtëzuara (Ministri linje, etj)
600-Paga	1,429,182	301,573	1,104,924			22,686
601-Sigurime Shoqërore	238,677	53,363	181,783			3,531
Shpenzime personeli (600+601)	1,667,859	354,935	1,286,707	-	-	26,217
602-Shpenzime Operative	1,300,592	526,353	749,283			24,956
603-Subvencion	-	0	0			0
604 -Transferime korrente të brendshme	61,161	46,064	0		1,250	13,847
605-Transferta korrente të jashtme	-	0	0		0	0
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	1,673,102	72,752	17,246		257,317	1,325,788
Shpenzime të tjera korrente	3,034,855	645,169	766,529	-	258,567	1,364,590
230-Projekte	9,616	9,616	0		0	0
231-Investime	2,158,109	763,658	124		1,348,726	45,601
Shpenzime kapitale	2,167,725	773,274	124	-	1,348,726	45,601
Totali	6,870,439	1,773,379	2,053,360	-	1,607,293	1,436,408
<i>Burimi i financimit në %</i>		26%	30%	-	23%	21%

Sikurse shihet nga tabela për vitin 2024 shpenzimet me volum më të madh janë shpenzimet korrente me 44.2%, mbas tyre vijnë shpenzimet kapitale me 31.5% dhe pastaj ato të personelit me 24.3%. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimet faktike rezultojnë 11% më të ulëta. Arsyeja kryesore janë shpenzimet që lidhen me fondet e rindërtimit të cilat kanë zbritur në 40%, sepse tashmë dihet që Fondi i Rindërtimit po shkon drejt përfundimit. Shpenzimet faktike për vitin 2024 janë financuar nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale në masën 30%, nga taksat dhe tarifat në masën 26%, nga fondet e rindërtimit në masën 23% dhe nga ministrinë e linjës në masën 21%. Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet faktike 2024 krahasuar me vitin 2023.

Tabela 2/1: Shpenzimet faktike 2023-2024 (në mijë lekë)

Emërtimi shpenzimit	Viti 2023 në mijë lekë	Viti 2024 në mijë lekë	Ndryshimi me 2023 në %
600-Paga	1,291,855	1,429,182	11
601-Sigurime Shoqërore	212,083	238,677	13
Shpenzime personeli (600+601)	1,503,939	1,667,859	11
602-Shpenzime Operative	1,162,324	1,300,592	12
603-Subvencion	-	-	-



Emërtimi shpenzimit	Viti 2023 në mijë lekë	Viti 2024 në mijë lekë	Ndryshimi me 2023 në %
604 -Transferime korrente të brendshme	84,384	61,161	-28
605-Transferata korrente të jashtme	-	-	-
606-Transferata Buxh.Fam.Ind	1,469,106	1,673,102	14
Shpenzime të tjera korrente (602,603,604,605,606)	2,715,814	3,034,855	12
230-Projekte	24,756	9,616	-61
231-Investime	3,443,983	2,158,109	-37
Shpenzime kapitale (230+231)	3,468,738	2,167,725	-38
Totali shpenzimeve faktike	7,688,484	6,870,439	-11
<i>Burimi i financimit :</i>			
Të ardhurat e veta (grup 00- kapitull 5)	1,736,745	1,773,379	2
Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale (grup 00- kapitull 1)	1,810,371	2,053,360	13
Të ardhura jashtë limit (grup 00-Kapitull 6)	30	-	
Fondet e rindërtimit	2,692,199	1,607,293	-40
Transferta e kushtëzuara (Ministri linje, FZHR etj)	1,449,146	1,436,408	-1

I. SHPENZIMET SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

I.1 Shpenzimet nga të ardhurat e veta dhe transferata e pakushtëzuar dhe sektoriale

Shpenzimet faktike të Bashkisë Durrës për vitin 2024 me burim financimi të ardhurat e veta dhe transferata e pakushtëzuar dhe sektoriale rezultojnë 3,826,739 mijë lekë dhe paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: Shpenzimet totale të grupit 00 sipas artikujve dhe burimeve të financimit, viti 2024 (në 000/lekë)

Grup	Llog.ekon	Totali		Transferta e pakushtëzuar Kapitull 1		Transferta specifike Kapitull 1		Të ardhurat Kapitull 5	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
00	600-paga	1,535,462	1,406,497	787,468	729,144	407,911	375,780	340,083	301,573
00	601-sigurime	255,074	235,146	129,672	120,221	63,185	61,562	62,218	53,363
00	602-Shp.operative	1,421,457	1,275,636	525,015	445,436	310,779	303,847	585,663	526,353
00	603-subvencione	-	-	-	-	-	-	-	-
00	604- transferata të brendshme	46,102	46,064	-	-	-	-	46,102	46,064

Grup	Llog.ekon	Totali		Transferata e pakushtëzuar Kapitull 1		Transferata specifike Kapitull 1		Të ardhurat Kapitull 5	
00	606- transferime tek individët	91,669	89,998	16,362	16,009	1,236	1,236	74,070	72,752
00	609- F.rezerv. dhe kontigjenca	20,000	-	20,000	-				
	Shp. korrente	3,369,765	3,053,340	1,478,517	1,310,810	783,111	742,426	1,108,136	1,000,104
00	230- kapitale patrupëzuara	15,627	9,616	-	-	-	-	15,627	9,616
00	231-kapitale trupëzuara	1,243,682	763,783	92,068	124	9,500	-	1,142,113	763,658
	Shp. kapitale	1,259,309	773,398	92,068	124	9,500	-	1,157,740	773,274
00	Total	4,629,073	3,826,739	1,570,586	1,310,934	792,611	742,426	2,265,876	1,773,379

Tabela 4: Shpenzimet faktike të grupit 00 sipas artikujve, viti 2023-2024 (në 000/lekë)

Grupi	Llogaria ekonomike	Viti 2023		Viti 2024		Ndryshimi në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	
00	600 (paga)	1,352,504	1,260,254	1,535,462	1,406,497	11.6
00	601 (sigurime)	224,873	209,370	255,074	235,146	12.3
00	602 (shp.operative)	1,280,883	1,118,006	1,421,457	1,275,636	14
00	603 (subvencione)	-	-	-	-	-
00	604 (transferata të brendshme)	40,000	40,000	46,102	46,064	15.1
00	606 (transferata për buxh. individë)	86,285	76,917	91,669	89,998	17
00	609 (F.rezervë dhe kontigjencës)	-	-	20,000	-	
00	Shp.korrente	2,984,546	2,704,547	3,369,765	3,053,340	12.8
00	230 (kapitale të grupëzuara)	25,095	24,756	15,627	9,616	-61.1
00	231(kapitale të grupëzuara)	1,030,474	817,813	1,243,682	763,783	-6.6
	Shp. kapitale	1,055,570	842,569	1,259,309	773,398	-8.2
	Total	4,040,115	3,547,116	4,629,073	3,826,739	7.9

Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe transferata e pakushtëzuar dhe sektoriale për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 janë rritur me 279,623 mijë lekë ose 7.9%. Rritjen më të madhe e kanë patur shpenzimet korrente me 12.8%. Rritje kanë pësuar edhe shpenzimet e personelit për arsye të rritjes së nivelit të pagave për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë. Gjatë vitit 2024 kanë pësuar ulje shpenzimet kapitale me 8.2%.

Buxheti nga të ardhurat e veta dhe transferatat e pakushtëzuara dhe sektoriale për vitin 2024 ishte 5,331,762 mijë lekë, plan thesari ishin 4,629,073 mijë lekë, kurse shpenzimet faktike 3,826,739 mijë lekë. Në mënyrë më të detajuar buxheti i rishikuar për çdo program buxhetor paraqitet si në tabelën e mëposhtme:



Tabela 5: Shpenzimet totale për çdo program, grupi 00 viti 2024 (në 000/lekë)

Gr.	Prog ram	Titulli	Plan i Rishikuar Viti 2024	Plani i Periudhës/ progresiv i 4 mujorit III-të	F a k t
1	00	01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	736,624	703,715	621,080
2	00	03140 Shërbimet e Policisë Vendore	112,359	97,359	78,784
3	00	03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	163,676	129,055	84,450
4	00	04130 Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	9,741	9,295	4,250
5	00	04220 Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	20,316	20,316	0
6	00	04240 Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	94,206	82,206	71,278
7	00	04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	7,060	7,060	3,703
8	00	04520 Rrjeti rrugor	574,187	451,560	367,390
9	00	04570 Transporti Publik	0	0	0
10	00	05100 Menaxhimi Mbetjeve	976,789	976,640	932,478
11	00	06140 Planifikimi Urban Vendor	237,441	196,242	169,818
12	00	06260 Shërbimet Publike Vendore	562,743	496,032	380,465
13	00	06370 Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	66,603	66,603	0
14	00	07220 Shërbimet e Kujdesit Parësor	4,661	4,661	2,511
15	00	08130 Sport dhe Argëtim	161,466	157,565	154,763
16	00	08220 Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	208,911	134,301	116,184
17	00	09120 Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	796,766	557,257	512,504
18	00	09230 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	283,577	282,435	124,626
19	00	10430 Përkujdesja Sociale	178,073	177,973	153,655
20	00	10661 Strehimi Social	69,177	58,797	48,800
	00		5,264,377	4,609,073	3,826,739
	00	Fondi rezervë	52,384	20,000	-
	00	Fondi kontigjencës	15,000	-	-
	00	TOTALI	5,331,762	4,629,073	3,826,739

Shënim: Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transfertat e kushtëzuar, FZHR, si dhe nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit.

1.2 Shpenzimet nga Fondi i Rindërtimit

Në periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor Bashkia Durrës ka përfutur fonde në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit 2024 me një vlerë totale prej 915,449 mijë lekë, për financimin e mëtejshëm të projekteve në proces, nga të cilat u çelën në thesar 710,483 mijë lekë. Në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak është bërë detajimi i këtyre fondeve pa ndryshuar destinacionin për të cilin janë alokuar. Po të shtojmë edhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës

2023 fondi i rindërtimit në 31 dhjetor 2024 kapi vlerën 2,729,218 lekë dhe nga ky fond janë çelur në thesar 2,524,223 lekë. Nga këto u disbursuan 1,607,293 mijë lekë ose 64% e planit. Fondet e papërdorura prej 916,930 mijë lekë trashëgohen në vitin 2025 me të njëjtin destinacion. Fondeve të papërdorura i shtohet edhe vlera prej 204,966 mijë lekë, alokuar sipas VKM nr.837 datë 26.12.2024, e cila rezulton si fond i pashpërndarë në vitin 2024. Në total shuma që mbetet për tu trashëguar për vitin 2025 është 1,121,896 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimet nga Fondi i Rindërtimit janë 1,084,905 mijë lekë më pak ose 40% më pak.

Fondi i rindërtimit për vitin 2024 paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: Fondet e rindërtimit sipas artikujve, viti 2024 (në 000/lekë)

Llogaria Ekonomike	Kapitull	Fakt 2023	Fonde të trashëguara nga 2023 për rindërtimin	Fonde rindërtimi të alokuara në 2024	Plan i çelur në thesar 2024	Fakt 2024	Ndryshimi me 2023 në %
1	2	3	4	5	6=4+5	7	8
230	Kap.1	-	7,503	-	7,503	-	-
231	Kap.1	2,619,364	1,797,546	453,051	2,250,597	1,348,727	-49
602	Kap.1		2,348	-	2,348	-	-
604	Kap.1	1,250	5,086	-	5,086	1,250	0
606	Kap.1	56,560	371	257,432	257,803	257,317	355
total	Kap.1	2,677,174	1,812,854	710,483	2,523,337	1,607,293	-40
604	Kap.6	14,600	885	-	885	-	-100
606	Kap.6	425	-	-	-	-	-100
total	Kap.6	15,025	885	-	885	-	-100
TOTALI Kap.1+ kap.6		2,692,199	1,813,739	710,483	2,524,222	1,607,293	-40
Plani i pashpërndarë sipas VKM nr.837 datë 26.12.2024				204,966			
TOTALI			1,813,739	915,449	2,524,222	1,607,293	

Në mënyrë të detajuar fondi i Rindërtimit që i është alokuar Bashkisë Durrës jepet në shtojcën 1: Fondi i Rindërtimit nga buxheti i shtetit.

1.3 Shpenzimet nga transfertat e kushtëzuar

Gjatë vitit 2024 Bashkia Durrës përfitoi fonde nga ministrinë e linjës për financimin e funksioneve të deleguara. Këto fonde janë me destinacion dhe përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë alokuar. Totali i këtyre fondeve të alokuara gjatë vitit 2024 kapi vlerën 1,471,166 mijë lekë. Nga këto u shpenzuan 1,436,408 mijë lekë, ose 98% e planit. Fondet e papërdorura nga transfertat e

kushtëzuar gjatë vitit 2024 nuk mbarten për vitin pasardhës. Në mënyrë të detajuar ato paraqiten si më poshtë:

Tabela 7: Transferta e kushtëzuar (fondet e Ministrive të linjës) viti 2024, në 000/lekë

Emërtimi produktit	Njësia shpenzuese	Grupi	Programi	Kap.	Kodi Produktit	Plani	Fakti
Subvencioni qerasë i familjeve në nevojë	Bashkia Durrës	12	06190	1	91208AC	34,624	34,624
Strehim (subvencioni qerasë i familjeve në nevojë kontrata me Entin e Banesave)	Bashkia Durrës	12	06190	1	91208AD	2,671	2,671
Pajisje mobilerie arsimit dhe mesëm i përgjithshëm	Bashkia Durrës	11	09230	1	M112627	3,252	-
Pagesa PAK	Bashkia Durrës	13	10430	1	91307AB	1,185,150	1,185,086
Ndihma ekonomike	Bashkia Durrës	13	10430	1	91307AA	40,077	38,936
Vendime gjyqësore PAK	Bashkia Durrës	13	10430	1	91307AL	42,797	42,693
Ofrime të shërbimeve të kujdesit shoqëror (Fondi social)	Bashkia Durrës	13	10430	1	91307AH	3,537	2,700
Gjendja Civile	Bashkia Durrës	16	01170	1	91603AA	27,768	26,277
Rikonstruksion i Teatrit Aleksandër Moisiu	Bashkia Durrës	12	08230	1	18AE717	55,720	40,059
Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme (fondi i kushtëzuar i mbrojtjes civile)	Bashkia Durrës	17	10910	1	91707AB	21,955	13,847
Përforsim terreni nga rrëshqitja në zonën e Njesisë Administrative Nr .2, Nr.4 dhe Ishëm	Bashkia Durrës	17	10910	1	18AZ901	5,542	5,542
Bursa të përfituara nga nxënësit AP	Bashkia Durrës	12	09240	1	91209AB	22,365	19,945
Fëmijë në nevojë që përfitojnë nga shërbimi arsimor	Bashkia Durrës	11	09120	1	91103AC	22,944	21,265
Nxënës që rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet	Bashkia Durrës	11	09230	1	91104AA	2,763	2,763
TOTALI 1+2						1,471,166	1,436,408

Transferta e kushtëzuar sipas natyrës ekonomike krahasuar me vitin 2023 është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 8: Transferta e kushtëzuar 2023-2024 (000/lekë)

Grupi	Llogaria ekonomike	Viti 2023		Viti 2024		Ndryshimi në % i faktit
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	
00	600 (paga)	36,490	31,601	23,890	22,686	-28.2
00	601 (sigurime)	3,478	2,714	3,803	3,531	30.1
00	602 (shp.operative)	45,488	44,318	28,540	24,956	-43.6
00	603 (subvencione)	-	-	-	-	-

Grupi	Llogaria ekonomike	Viti 2023		Viti 2024		Ndryshimi në % i faktit
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	
00	604 (transferta të brendshme)	38,975	28,504	21,955	13,847	-51.4
00	606 (transferta për buxh. individë)	1,382,090	1,335,204	1,328,464	1,325,788	-0.7
00	Shp.korrente	1,506,522	1,442,342	1,406,651	1,390,808	-3.5
00	230 (kapitale të patrupëzuara)	-	-	-	-	-
00	231 (kapitale të trupëzuara)	20,324	6,805	64,514	45,600	570
	Shp. kapitale	20,324	6,805	64,514	45,600	570
	Total	1,526,845	1,449,147	1,471,166	1,436,408	-0.8

Sikurse shihet nga tabela për vitin 2024 nga Ministritë e Linjës fondet e alokuara janë 55,680 mijë lekë më pak krahasuar me 2023. Gjatë vitit 2024 nuk pati fonde të alokuara për subvencionimin e qerasë së familjeve të dëmtuara nga tërmeti.

II. INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT NGA TË ARDHURAT E VETA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE SEKTORIALE

Në tabelën e mëposhtëme po paraqesim si ka ndryshuar buxheti për grupin 00 (pa fondin e rindërtimit) gjatë vitit 2024.

Tabela 9: Ndryshimet e buxhetit për çdo program, viti 2024 (në 000/lekë)

Gr.	Emërtimi programit	Kodi programit	Plan Fillestar Viti 2024 (miratuar me VKB nr.195 dt.22.12.2023)	Fondet e trashëguara nga viti 2023 (miratuar me VKB nr.38 dt.21.05.2024)	Rialokimet gjatë vitit	Plan i Rishikuar (progresiv i)	Ndryshimet në vlerë	Ndryshimi në %
		1	2	3	4	5=2+3+4	6=5-2	7
00	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	01110	505,395	123,383	107,846	736,624	231,229	45.8
00	Shërbimet e Policisë Vendore	03140	111,073	-	1,286	112,359	1,286	1.2
00	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	03280	143,216	15,627	4,833	163,676	20,460	14.3
00	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	04130	3,430	6,311	-	9,741	6,311	184
00	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore	04220	-	20,316	-	20,316	20,316	-
00	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	04240	73,422	20,279	505	94,206	20,784	28.3
00	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	04260	3,819	3,241	-	7,060	3,241	84.9
00	Rrjeti rrugor	04520	427,121	126,859	20,208	574,187	147,067	34.4
00	Transporti Publik	04570	-	-	-	-	-	-

Gr.	Emërtimi programit	Kodi programit	Plan Fillestar Viti 2024 (miratuar me VKB nr.195 dt.22.12.2023)	Fondet e trashëguara nga viti 2023 (miratuar me VKB nr.38 dt.21.05.2024)	Rialokimet gjatë vitit	Plan i Rishikuar (progresiv i)	Ndryshimet në vlerë	Ndryshimet në %
		1	2	3	4	5=2+3+4	6=5-2	7
00	Menaxhimi Mbetjeve	05100	969,905	-	6,884	976,789	6,884	0.7
00	Planifikimi Urban Vendor	06140	196,908	37,277	3,257	237,441	40,533	20.6
00	Shërbimet Publike Vendore	06260	510,201	48,908	3,634	562,743	52,542	10.3
00	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	06370	-	66,603	-	66,603	66,603	-
00	Shërbimet e Kujdesit Parësor	07220	-	4,661	-	4,661	4,661	-
00	Sport dhe Argëtim	08130	135,160	25,667	639	161,466	26,306	19.5
00	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	08220	190,236	17,264	1,411	208,911	18,675	9.8
00	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	09120	715,799	61,996	18,970	796,766	80,967	11.3
00	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	09230	256,437	27,140	-	283,577	27,139	10.6
00	Përkujdesja Sociale	10430	170,804	1,650	5,619	178,073	7,269	4.3
00	Strehimi Social	10661	51,177	18,000	-	69,177	18,000	35.2
			4,464,104	625,182	175,092	5,264,377	800,274	17.9
	Fondi rezervë		35,000	40,000	(22,616)	52,384	17,384	49.7
	Fondi kontigjencës		15,000	-	-	15,000	-	-
	TOTALI		4,514,104	665,182	152,476	5,331,762	817,658	18.1

Buxheti i Bashkisë Durrës (grupi 00) për vitin 2024 së bashku me fondet e trashëguara nga viti 2023 prej 665,182 mijë lekë kapi vlerën 5,179,286 mijë lekë. Gjithashtu gjatë vitit pati nga buxheti i shtetit alokime fondesh në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale për efekt të rritjes së pagave me një vlerë totale 152,476 mijë lekë. Duke përfshirë edhe këto alokime buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2024, nga burimet e veta dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale ishte 5,331,762 mijë lekë, pra rezulton që gjatë vitit të jetë shtuar 18.1%.

Shtesa apo rishpërndarjet e fondeve ndërmjet programeve buxhetore në grupin 00 janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe janë 5 raste si më poshtë:

Tabela 10: Alokimet dhe rialokimet e fondeve, viti 2024 (në 000/lekë)

Nr.	Struktura buxhetore	Llog.e kon.	Kap	Shtesa	Pakësime	Totali ndyshimeve	Emërtimi i fondit	Nr. dhe Data vendimit
1	03280	600	01	3,833	-	3,833	Për miratimin e detajimit të fondeve të alokuara nga buxheti i	VKB NR. 89 DT 24.09.2024

Nr.	Struktura buxhetore	Llog.e kon.	Kap	Shtesa	Pakësime	Totali ndyshimeve	Emërtimi i fondit	Nr. dhe Data vendimit
	03280	601	01	1,000	-	1,000	shtetit për efekt të rritjes së pagave të punonjësve të tjerë jomësimore në institucionet arsimore dhe institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, si dhe punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	
	09120	600	01	20,713	-	20,713		
	09120	601	01	4,171	-	4,171		
	09120	600	01	70	-	70		
	09120	601	01	140	-	140		
	TOTALI 1			29,927	-	29,927		
2	04910	609	05	-	(6,064)	(6,064)	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Durrës për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit në Bashkinë Durrës.	VKB NR. 98 DT 24.09.2024
	01110	604	05	6,064	-	6,064		
	TOTALI 2			6,064	(6,064)	-		
3	01110	600	01	4,600	-	4,600	Për miratimin e detajimit të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për efekt të rritjes së pagave.	VKB NR.92 DT 28.10.2024
	01110	601	01	1,895	-	1,895		
	03140	600	01	1,100	-	1,100		
	03140	601	01	186	-	186		
	06140	600	01	540	-	540		
	06140	601	01	90	-	90		
	08220	600	01	867	-	867		
	08220	601	01	145	-	145		
	10430	600	01	3,970	-	3,970		
	10430	601	01	663	-	663		
	08130	600	01	366	-	366		
	08130	601	01	61	-	61		
	08130	600	01	182	-	182		
	08130	601	01	30	-	30		
	05100	600	01	2,500	-	2,500		
	05100	601	01	860	-	860		
	06260	600	01	343	-	343		
	06260	601	01	57	-	57		
	04240	600	01	433	-	433		
	04240	601	01	72	-	72		
	04520	600	01	1,850	-	1,850		

Nr.	Struktura buxhetore	Llog.e kon.	Kap	Shtesa	Pakësime	Totali ndryshimeve	Emërtimi i fondit	Nr. dhe Data vendimit
	04520	601	01	309	-	309		
	06260	600	01	241	-	241		
	06260	601	01	40	-	40		
	05100	600	01	3,000	-	3,000		
	05100	601	01	524	-	524		
	10430	600	01	845	-	845		
	10430	601	01	141	-	141		
	08220	600	01	342	-	342		
	08220	601	01	57	-	57		
	06260	600	01	2,530	-	2,530		
	06260	601	01	423	-	423		
	TOTALI 3			29,262	-	29,262		
4	04520	231	05	-	(8,000)	(8,000)	Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e këshillit bashkiak nr.195 dt.22.12.2023, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024.	VKB NR.97 DT.28.10.2024
	04520	231	05	-	(250)	(250)		
	09120	231	05	-	(6,000)	(6,000)		
	09120	231	05	-	(113)	(113)		
	09120	231	05	-	(11)	(11)		
	04910	609	05	-	(16,552)	(16,552)		
	06140	230	05	2,627	-	2,627		
	04520	231	05	26,299	-	26,299		
	01110	602	05	2,000	-	2,000		
	TOTALI 4			30,926	(30,926)	-		
5	01110	602	01	93,287	-	93,287	Për miratimin e përdorimit të transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale shtesë të alokuara në zbatim të aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023!" Për buxhetin e vitit 2024" të ndryshuar	VKB NR.119 DT.24.12.2024
	TOTALI 5			93,287	-	93,287		
	TOTALI			189,466	(36,990)	152,476		

Fondi rezervë i planifikuar për vitin 2024 ishte 75,000 mijë lekë dhe është përdorur bazuar në dy vendime të Këshillit Bashkiak përkatësisht: vendimit nr.97 datë 28.10.2024 "Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.195 datë 22.12.2023, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024" në vlerën 16,552 mijë lekë, si dhe vendimit nr.98 datë 28.10.2024 "Për miratimin e përdorimit të fondit prej 6,064,000 lekë, të alokuara nga Bashkia Durrës në zbatim të VKB-së nr.90 datë 24.09.2024 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Durrës për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të

papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit në Bashkinë Durrës” në vlerën 6,064 mijë lekë. Vlera totale e përdorur e këtij fondi është 22,616 mijë lekë dhe mbeti pa përdorur 52,384 mijë lekë.

Fondi i kontigjencës i planifikuar për vitin 2024 ishte në vlerën 15,000 mijë lekë dhe nuk është përdorur.

Fondi i emergjencave civile është krijuar nga të ardhurat e veta të Bashkisë ku për vitin 2024 paraqitet në shumën 14,000 mijë lekë në programin e mbrojtjes civile (kodi programit 03280) dhe nuk është përdorur.

Fondi i kushtëzuar i emergjencave civile për vitin 2024 i alokuar nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ishte 21,955,456 lekë. Realizimi financiar i tij është 13,847,077 lekë, me 25 përfitues. Ky fond është përdorur me vendime të veçanta të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Tabela 11: Përdorimi i fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile, viti 2024 (në 000/lekë)

Gr.	Program	Kap.	Kod produkti	Llog. ekon.	Fondi i detajuar sipas VKB	Realizimi financiar në lekë	Nr.përfituesve faktike	NR. DHE DT. VKB	EMËRTIMI
17	10910	01	91707AB	604	5,829	5,829	7 persona	VKB nr.58 dt.25.06.2024	“Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 5.829.106 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”
17	10910	01	91707AB	604	4,133	4,133	6 persona	VKB nr.107 dt.16.12.2024	“Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4.133.471 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”
17	10910	01	91707AB	604	3,885	3,885	12 persona	VKB nr.147 dt.28.09.2023	“Ndihmë financiare për familjet e dëmtuara si pasojë e përmbytjes nga reshjet e shiut të datës 19.03.2018.”
					13,847	13,847	25 persona		

III. KARAKTERISTIKA KRYESORE TË PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE

Për vitin 2024 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale krahasuar me buxhetin dhe planin e periudhës, paraqitet si më poshtë:

Tabela 12: Realizimi shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat në %, viti 2024

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2024	
				% e realizimit të kundrejt buxhetit	% e realizimit kundrejt planit të periudhës
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	84.3	88.3
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	70.1	80.9
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	51.6	65.4
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	43.6	45.7
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	-	-
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	75.7	86.7
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	52.5	52.5
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	64	81.4
00	P9	04570	Transporti Publik	-	-
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	95.5	95.5
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	71.5	86.5
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore	67.5	76.7
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-
00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	53.9	53.9
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	95.8	98.2
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	55.6	86.5
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	64.3	92
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	43.9	44.1
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	86.3	86.3
00	P20	10661	Strehimi Social	70.5	83
TOTALI I SHPENZIMEVE				72	83

Pra siç shikohet nga të dhënat e tabelës së mësipërme plani i shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat (grupi 00) për Bashkinë Durrës për vitin 2024 është realizuar në masën 72%, kurse ai i periudhës është realizuar 83%. Krahasuar me vitin 2023 rezulton që realizimi i buxhetit (grupi 00) të jetë ulur me 4% dhe realizimi kundrejt planit të periudhës është ulur me 5% krahasuar me vitin 2023. Për vitin 2024 programi me realizimin më të lartë të buxhetit është programi “Sport dhe Argëtim” (kodi 08130) me 95.8%, kurse programi me realizimin më të ulët është programi “Mbështetja për zhvillimin ekonomik” (kodi 04130).

Pesha specifike e shpenzimeve faktike në vitin 2024, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13: Pesha specifike e shpenzimeve faktike në %

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Pesha specifike
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	16.2
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	2.1
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	2.2
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	0.1

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Pesha specifike
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	-
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	1.9
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	0.1
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	9.6
00	P9	04570	Transporti Publik	-
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	24.4
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	4.4
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore	9.9
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-
00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	0.1
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	4
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	3
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	13.4
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	3.3
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	4
00	P20	10661	Strehimi Social	1.3
TOTALI I SHPENZIMEVE				100

Duke parë strukturën e realizimit të shpenzimeve (grupi 00) për vitin 2024, vërejmë që pjesën më të madhe të shpenzimeve faktike e zënë shpenzimet e programit “Menaxhimi i mbetjeve” me 24.4% dhe programi “Arsimi bazë përfshirë parashkollorin” me 16.2%, kurse programi me peshë specifike më të ulët është programi “Shërbimet e Kujdesit Parësor” me 0,07%.

Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektorialet për vitin 2024 janë 3,826,739 mijë lekë ose 7.8% më shumë se viti 2023. Sipas programeve buxhetore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14: Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale, 2023-2024 (000/lekë)

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2023	Viti 2024	Ndryshi mi në %
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	494,937	621,080	25.4
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	75,694	78,784	4
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	65,892	84,450	28.1
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	919	4,250	362
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	-	-	-
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	95,425	71,278	-25.3
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	2,615	3,703	41.6
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	387,723	367,390	-5.2
00	P9	04570	Transporti Publik	-	-	-
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	965,717	932,478	-3.4
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	17,100	169,818	893
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore-	401,715	380,465	-5.2
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-	-



00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	11,387	2,511	-78
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	121,973	154,763	26.8
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	71,181	116,184	63.2
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	566,002	512,504	-9.5
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	102,142	124,626	22
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	130,742	153,655	17.5
00	P20	10661	Strehimi Social	35,952	48,800	35.7
TOTALI I SHPENZIMEVE				3,547,116	3,826,739	7.8

Krahasuar me vitin 2023 vihet re që shpenzimet për programin “Planifikimi Urban Vendor” kanë pësuar rritjen më të madhe me 893%, kjo për arsye se në këtë program janë planifikuar objektet e financuara nga Bashkia në kuadër të procesit të rindërtimit. Viti 2024 është viti i parë në të cilin Bashkia planifikoi fonde nga të ardhurat e veta për rindërtimin.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, korrente e kapitale situata gjatë **vitet 2024**, paraqitet si më poshtë:

Shpenzimet korrente

Për vitin 2024 shpenzimet korrente (grupi 00) kapën vlerën 3,053,340 mijë lekë ose 12.8% më shumë se viti 2023. Për vitin 2024 shpenzimet korrente zënë **79.7% të shpenzimeve faktike**. Pra volumi i tyre është në rritje me 3.7% krahasuar me vitin 2023 në të cilin zinin një peshë specifike prej 76%. Realizimi kundrejt planit vjetor të buxhetit është 90%, kurse kundrejt planit të periudhës është 91.2%. Në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 15 : Shpenzimet korrente viti 2024, (në 000/lekë)

Art.	Emërtimi	Fakti 2023	Buxhet filestar 2024	Buxhet i rishikuar 2024	Plan thesari 2024	Fakt 2024	Realizim i kundrejt buxhetit në%	Pesha specifi ke në %
600	Paga	1,260,254	1,454,475	1,541,181	1,535,462	1,406,497	91.3	36.8
601	Sig.shoqërore	209,370	239,031	255,074	255,074	235,146	92.2	6.1
602	Mallra dhe shërbime	1,118,006	1,247,736	1,442,279	1,421,457	1,275,636	88.4	33.3
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta korrente të brendshme	40,000	20,000	46,064	46,102	46,064	100	1.2
605	Transferta korrente të huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Tranf. për buxh.fam.&indi	76,917	93,500	99,950	91,669	89,998	90	2.4
609	Rezerva dhe kontigjenca		50,000	67,384	20,000			
TOTALI		2,704,547	3,104,742	3,451,932	3,369,765	3,053,340	90.2	79.8

Shpenzimet e personelit për vitin 2024 janë në vlerën 1,641,642 mijë lekë ose 11.7% më të larta se viti 2023. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së nivelit të pagave gjatë vitit 2024 për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë. Ato zënë 42.8% të totalit të shpenzimeve faktike. Për nga madhësia renditen të parat. Realizimi i tyre gjatë vitit 2024 është në masën 91.3% kundrejt buxhetit.

Nr.total i punonjësve për vitin 2024 ishte 1,924 veta për 12 njësi shpenzuese. Arsyet e realizimit në këtë masë janë:

1. Mosplotësimi i vendeve vakante
2. Mospërdorimi i fondit të veçantë
3. Raportet e paaftësisë për punë për periudhën mbi 2 javë të cilat paguhen nga sigurimet shoqërore.

Shpenzimet operative faktike për vitin 2024 janë 1,275,636 mijë lekë dhe zënë 33.3% të shpenzimeve totale. Krahasuar me vitin 2023 këto shpenzime janë rritur me 1.3%.

Transferrat tek individët/buxhetet familjare faktike për vitin 2024 kapën vlerën 89,998 mijë lekë. Në këtë grup shpenzimesh përfshihet:

- Ndihma financiare për sëmundje, vdekje dhe dalje në pension në zbatim të VKM nr.493 dt. 06.07.2011 “Për disa ndryshime në VKM nr.929 dt.17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” me një vlerë totale 5,642 mijë lekë. U trajtuan 108 individë.
- Ndihma financiare e alokuar nga Bashkia për familjet në nevojë që nuk përfitojnë nga skema e NE, me një fond prej 6,602 mijë lekë, nga i cili përfituan 146 familje.
- Shpërblimi për nxënësit ekselent të shkollave të mesme dhe 9 vjeçare me vlerë 3,835 mijë lekë. Përfituan 90 nxënës, nga të cilët 66 nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe 24 nxënës të shkollave të mesme.
- Subvencionimi i qerasë për familjet në nevojë në vlerë 13,920 mijë lekë. U trajtuan 98 familje.
- Trajtimi ushqimor i sportistëve dhe trajnerëve të tyre pranë Klubit të Shumësporteve me vlerë 59,999 mijë lekë. U trajtuan 170 sportistë dhe 32 trajnerë.

Shpenzimet kapitale

Për vitin 2024 shpenzimet kapitale faktike ishin në vlerën 773,398 mijë lekë ose 8.2% më pak se viti 2023. Ato zënë 20.2% të shpenzimeve faktike dhe paraqiten si në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 16: Shpenzimet kapitale viti 2024, (në 000/lekë)

Art.	Emërtimi	Fakt 2023	Buxhet fillestar 2024	Buxhet i rishikuar 2024	Plan i çelur në thesar 2024	Fakt 2024	Realizimi kundrejt buxhetit në%	Pesha specifike në %
230	Kapitale të Patrupëzuara	24,756	15,000	29,627	15,627	9,616	32.5	0.3
231	Kapitale të Trupëzuara	817,813	1,394,361	1,850,203	1,243,682	763,783	41.3	20



Art.	Emërtimi	Fakt 2023	Buxhet fillestar 2024	Buxhet i rishikuar 2024	Plan i çelur në thesar 2024	Fakt 2024	Realizimi kundrejt buxhetit në%	Pesha specifike në %
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	842,569	1,409,361	1,879,829	1,259,309	773,398	41.1	20.2
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	-	-
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	842,569	1,409,361	1,879,829	1,259,309	773,398	41.1	20.2

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim nga të ardhurat e bashkisë dhe transfertat për vitin 2024, sipas programeve është si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 17: Realizimi shpenzimeve kapitale (grupi 00) për çdo program, viti 2024

P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2024	
			% e realizimit të kundrejt buxhetit	% e realizimit kundrejt planit të periudhës
P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	57.1	98.8
P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	-	-
P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	16	21.9
P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	20.8	20.8
P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	0	0
P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	14.5	100
P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	-	-
P8	04520	Rrjeti rrugor	56.4	77.4
P9	04570	Transporti Publik	-	-
P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	85.1	100
P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	70.9	87.8
P12	06260	Shërbimet Publike Vendore	51	64.1
P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-
P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	53.9	53.9
P15	08130	Sport dhe Argëtim	90.4	100
P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	21.9	67.3
P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	15.9	86.6
P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	17.9	18.1
Ky grup të ardhurash për vitin 2024 rezulton në vlerën 2,303,708 mijë lekë dhe zë 24% të të ardhurave të përgjithshme të arkëtuara për vitin 2024, ndërsa po të heqim fondet e rindërtimit dhe ato të Minsitrive të Linjës të cilat janë fonde për funksione të deleguara, të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore zënë 42%. Krahasuar me vitin 2023 të ardhurat nga burimet e veta rezultojnë 24% më të larta. Sipas zërave kryesorë paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 25: Të ardhurat nga burimet e veta për vitet 2024 (në 000/lekë)

NR.	EMERTIMI TË ARDHURAVE	Plani 2024 000/lekë	Fakti 2024 000/lekë	Realizimi në %
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA (A1+A2+A3+A4)	2,344,450	2,303,708	98%
A.1	TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	1,133,000	970,343	86%
A.2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	315,050	330,062	105%
A.3	TË ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	802,400	825,615	103%
A.4	TË ARDHURA TË TJERA	94,000	177,688	189%

Në lidhje me realizimin e të ardhurave vendore për periudhën Janar-Dhjetor 2024 mbështetur në rakordimet me Thesarin, po ju paraqesim një pasqyrë me zërat kryesorë që kanë peshë në të ardhurat e Buxhetit të Bashkisë, duke analizuar realizimet dhe mosrealizimet, shkakët objektive dhe subjektive që kanë ndikuar realizimin e tyre.

Realizimi vjetor i të ardhurave të Bashkisë për vitin 2024 ka arritur në 98% të planit vjetor. Gjatë vitit 2024 janë arkëtuar 452,137 mijë lekë më shumë krahasuar me vitin 2023, duke shënuar një rritje prej 24%. Ky rezultat është i lidhur ngushtë me rritjen e të ardhurave të mbledhura nga debitorët, si pasojë e masave shtrënguese të ndërmarra ndaj subjekteve, si dhe përmirësimit të mbledhjes së të ardhurave nga taksapaguesit familjarë.

Në vitin 2024, numri i subjekteve të reja të regjistruara në Bashkinë Durrës ka arritur në 1,788, me kategorinë e shërbimeve dhe tregtisë që kryeson, ndërsa janë mbyllur 326 subjekte dhe janë pezulluar 355 të tjera. Kjo dinamikë ka kontribuar në rritjen e të ardhurave të mbledhura për vitin 2024. Në total, numri i subjekteve aktive është 13,394, prej të cilave 8,159 janë biznese të vogla dhe 4,365 janë biznese të mëdha.

A.1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

Për vitin 2024, realizimi i të ardhurave ka arritur në 98% të planit të parashikuar për këtë vit. Krahasuar me vitin e kaluar, është realizuar një rritje prej 452,137 mijë lekësh, duke theksuar se kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së arkëtimeve nga taksat dhe tarifatat vendore të mbledhura nga familjet dhe bizneset.

Tatimi i thjeshtuar i fitimit për biznesin e vogël

Ky tatim mbledhet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila përfiton 1% të të ardhurave të mbledhura. Taksimi bazohet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 30.12.2013.

Për Tatimin e Thjeshtuar, sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar me Ligjin nr. 106/2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 26.02.2020, që ka hyrë në fuqi nga 1 janari 2021 dhe do të vijojë deri në vitin 2029, neni 28, pika 1, gërma a), përcakton se për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit, shkalla e tatimit do të jetë 0%. Në këtë kategori përfshihen edhe tatimpaguesit që janë subjekte të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin (nga 0 deri në 8 milion lekë).

Si rezultat, të ardhurat e mbledhura për këtë kategori janë debia e mbetur. Duke iu referuar të ardhurave të vitit 2023, të cilat ishin 4,426 mijë lekë, realizimi i këtij tatimi për vitin 2024 ka arritur në 4,822 mijë lekë, duke u rritur me 396 mijë lekë krahasuar me vitin 2023.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Planifikimi i të ardhurave nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme për vitin 2024 ishte 532,000 mijë lekë, ndërsa realizimi i të ardhurave ka arritur në vlerën 515,238 mijë lekë, që përbën 97% të planit të vitit 2024. Ky realizim është mbështetur në rritjen e mbledhjes së të ardhurave nga taksa e ndërtesës për familjet dhe bizneset. Taksa mbi ndërtesat është realizuar në 99% të planit vjetor. Krahasuar me vitin 2023, janë mbledhur 150,076 mijë lekë më shumë, duke shënuar një rritje prej 51% në krahasim me vitin e kaluar.

Për vitin 2024, Taksa e pasurisë për familjet është realizuar në vlerën 131,733 mijë lekë, ose 80% të planit të vitit 2024. Krahasuar me vitin 2023, kjo taksë është realizuar me 70,300 mijë lekë më shumë, si rezultat i mbledhjes së detyrimeve të prapambetura nga ana e agentit tatimor UKD.

Të ardhurat nga taksa e pasurisë për bizneset janë realizuar në vlerën 312,730 mijë lekë, ose 110% ndaj planifikimit. Krahasuar me vitin 2023, janë realizuar 79,776 mijë lekë më shumë, duke shënuar një rritje prej 34% në krahasim me vitin e kaluar. 29% e të ardhurave totale të mbledhura gjatë këtij viti janë të ardhura nga borxhi.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Taksa mbi ndërtesën viti 2023-2024 (në lekë)



Taksa mbi tokën bujqësore

Për vitin 2024, realizimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore është 35% i planit të parashikuar, me një vlerë prej 15,638 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2023, realizimi është rritur me rreth 6,608 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 73%, e cila është pasojë e rritjes së aplikimeve nga qytetarët lidhur me transaksionet që kanë lindur nga kjo taksë.

Megjithatë, edhe pse të ardhurat janë më të larta krahasuar me vitin e kaluar, mosrealizimi i plotë i objektivave për taksën mbi tokën bujqësore për vitin 2024 ka ardhur si pasojë e problematikave ligjore që lidhen me pronat (tokat bujqësore), të cilat në shumë zona nuk janë të azhuruara dhe nuk është realizuar menaxhimi i tyre. Po ashtu, ndarja e pasurisë për familjarët përfitues sipas ligjit nr. 7501 ka krijuar pengesa, ndërsa mungesa e informacionit dhe dokumentacionit përkatës për këtë taksë ka ndikuar në pamundësinë e marrjes së masave për mbledhjen e detyrimeve me forcë.

Ne kemi mbajtur korespondencë dhe kemi kërkuar nga Drejtoria e Kadastrës që, me të dhënat e marra prej tyre, të ndërtojme regjistrin e tokave bujqësore. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është realizuar nga ana e Drejtorisë, çka ka penguar krijimin e një regjistri nga ana jonë dhe ka vështirësuar mundësinë për të rritur mbledhjen e të ardhurave nga kjo taksë.


Taksa e truallit

Për vitin 2024, kjo taksë ishte planifikuar në vlerën 37,000 mijë lekë, nga të cilat 32,000 mijë lekë ishin parashikuar të mbledheshin nga taksapaguesit biznes dhe 5,000 mijë lekë nga taksapaguesit familjarë. Taksa e truallit nga biznesi është realizuar në vlerën 54,818 mijë lekë, ose 171% të planit të vitit 2024. Krahasuar me vitin e kaluar, janë mbledhur 97% më shumë, ku 42% e të ardhurave janë nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura.

Nga ana tjetër, taksa e truallit për familjarët është realizuar në një nivel shumë të ulët, me vetëm 138 mijë lekë, që përbën 6% të planit vjetor. Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së informacionit mbi tokat truall që disponojnë qytetarët. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, janë mbledhur 196% më shumë të ardhura nga kjo taksë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore do të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për mbledhjen e informacionit mbi këtë taksë dhe krijimin e regjistrit përkatës.

Taksa mbi truallin 2023-2024 (në lekë)



Taksa e Fjetjes në Hotel

Për vitin 2024, kjo taksë ishte planifikuar në vlerën 65,000 mijë lekë, ndërsa vlera e arkëtuar ka arritur në 152,921 mijë lekë, që përbën 235% të planifikimit vjetor. Kjo rritje e të ardhurave është rezultat i rritjes së turizmit në vendin tonë, menaxhimit të mirë dhe punës së realizuar, ku 18% e këtyre të ardhurave janë mbledhje detyrimesh të prapambetura. Krahasuar me vitin 2023, kemi një rritje prej rreth 65,391 mijë lekë më shumë, që përbën 134% më shumë se viti 2023.

Taksa në shërbimin në hotel 2023-2024 (në lekë)



Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja


Për vitin 2024, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ishte planifikuar në vlerën 460,000 mijë lekë, ndërsa vlera e arkëtuar ka arritur në 235,868 mijë lekë, që përbën 51% të planit vjetor. Krahasuar me vitin e kaluar, janë arkëtuar 133,572 mijë lekë më pak, që përbën një ulje prej 36%.

Duke marrë parasysh se baza e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri, për vitin 2024 janë miratuar 242 aplikime për leje ndërtimi. Krahasuar me vitin 2023, ka një rritje prej rreth 13 lejeve më shumë, pasi në vitin 2023 u miratuan 229 aplikime për leje ndërtimi.

Megjithatë, ulja e te ardhurave ka ardhur si pasojë e faktit që, pavarësisht numrit më të lartë të lejeve të dhëna, vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri, ka qenë më e ulët krahasuar me aplikimet për leje të vitit të kaluar.

Pagesat e Lejeve të Taksës së ndikimit në infrastrukturë 2023-2024

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja



Taksa e tabelës dhe reklamës

Për vitin 2024, taksa e tabelës dhe reklamës ishte planifikuar në shumën 31,000,000 lekë. Realizimi i kësaj takse ka arritur në 27,233 mijë lekë, që përbën 88% të planifikimit vjetor. Krahasuar me vitin 2023, realizimi është rritur me 8,763 mijë lekë, ose 47%, si pasojë e rritjes së numrit të tabelave identifikuese dhe reklamuese.

Megjithëse është rritur numri i subjekteve që kanë kërkuar heqjen e tabelave identifikuese mbi 2m², janë mbledhur më shumë të ardhura nga kjo taksë, duke kontribuar edhe mbledhja e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, të cilat përbëjnë 17% të të ardhurave totale të mbledhura.

A.2 TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA


Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme kanë arritur vlerën prej 52,966 mijë lekësh, duke përbushur 96% të planit vjetor. Megjithatë, në krahasim me vitin 2023, të ardhurat e realizuara janë 9% më të ulëta, ose 5,357 mijë lekë më pak. Ky reduktim është pasojë e uljes së numrit të aplikimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, e cila vepron si agjent për mbledhjen e kësaj takse.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Të ardhurat nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura për vitin 2024 kanë arritur vlerën prej 190,446 mijë lekësh, duke realizuar 100% të planit vjetor. Krahasuar me vitin 2023, kjo taksë ka shënuar një rritje prej 9%, duke reflektuar një tendencë pozitive në mbledhjen e saj.

Të ardhurat nga Taksat e ndara 2023-2024



A.3 TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2024 kanë shënuar një rritje prej 230,893 mijë lekësh, ose 39% më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Planifikimi vjetor i këtyre të ardhurave është parashikuar në 802,400 mijë lekë, ndërsa arkëtimet kanë tejkaluar pritshmëritë, duke arritur në 103% të planit vjetor. Kjo rritje është rezultat i përmirësimit të arkëtimit të tarifave familjare, kryesisht nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura në sistemin e Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës (UKD), i cili ka dyfishuar të ardhurat në krahasim me vitet e mëparshme. Gjithashtu, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka ndërmarrë masa për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura nga subjektet e biznesit, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e arkëtimit nga tarifat e biznesit. Më poshtë paraqitet një analizë më e detajuar për tarifat kryesore:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga familjet

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave përbën një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga tarifat vendore. Siç është theksuar më herët, po ndërmerren hapa për të dyfishuar numrin e

familjeve të përfshira në skemën e faturimit të taksave dhe tarifave. Aktualisht, numri i familjeve të faturuara ka arritur në 75,000. Për vitin 2024, të ardhurat e arkëtuara nga kjo tarifë kapin vlerën e 141,548 mijë lekëve, duke përfaqësuar 88% të planit vjetor. Në krahasim me vitin 2023, arkëtimet janë rritur me 69,628 mijë lekë, ose 97% më shumë. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura të taksapaguesve familjarë gjatë muajve të parë të vitit 2024.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga biznesi

Kjo tarifë është e lidhur ngushtë me aktivitetin e subjekteve tregtare, duke përfshirë hapjen e bizneseve të reja, pezullimet dhe mbylljet e tyre gjatë vitit fiskal.

Në vitin 2024, të ardhurat nga kjo tarifë kanë arritur vlerën e 222,763 mijë lekëve, duke tejkaluar planin vjetor në masën 106%. Në krahasim me vitin 2023, kur të ardhurat nga kjo tarifë ishin 169,549 mijë lekë, arkëtimet janë rritur me 53,214 mijë lekë, ose 31% më shumë.

Nga totali i të ardhurave të realizuara për vitin 2024, rreth 31% përbëhet nga arkëtimi i detyrimeve të prapambetura. Në këtë drejtim, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë masa konkrete për të përmirësuar procesin e mbledhjes së këtyre detyrimeve dhe për të reduktuar nivelin e borxhit të akumuluar.

Të ardhurat nga Tarifa e pastrimit të mbetjeve 2023-2024



Tarifa e ndriçimit nga familjet


Gjatë vitit 2024, të ardhurat e arkëtuara kanë arritur vlerën prej 62,395 mijë lekësh, duke përfaqësuar 178% të planit vjetor. Krahasuar me vitin 2023, të ardhurat e realizuara janë rritur me 30,746 mijë lekë, ose 97% më shumë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i mbledhjes së detyrimeve të prapambetura si dhe të detyrimeve vjetore të mbledhura nga Agjenti Tatimor.

Tarifa e ndriçimit nga biznesi

Për vitin 2024, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit për bizneset kanë arritur vlerën e 41,693 mijë lekëve, duke realizuar 97% të planit vjetor. Në krahasim me vitin 2023, kur të ardhurat e arkëtuara nga kjo tarifë ishin 33,455 mijë lekë, është shënuar një rritje prej 8,238 mijë lekësh, ose 25% më shumë.

Nga totali i të ardhurave të realizuara për vitin 2024, 28% përbëhet nga arkëtimi i detyrimeve të prapambetura, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Të ardhurat nga Tarifa e ndriçimit 2023-2024



Tarifa e gjelbërimit nga familjet

Gjatë vitit 2024, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e gjelbërimit për familjet kanë arritur vlerën prej 40,202 mijë lekësh, duke përfaqësuar 287% të planit vjetor. Krahasuar me vitin 2023, të ardhurat e realizuara janë rritur me 17,939 mijë lekë, ose 81% më shumë.

Tarifa e gjelbërimit nga biznesi

Për vitin 2024, të ardhurat nga tarifa e gjelbërimit për bizneset kanë arritur vlerën e 45,632 mijë lekëve, duke përmbushur 109% të planit vjetor. Në krahasim me vitin 2023, kur të ardhurat e arkëtuara nga kjo tarifë ishin 35,173 mijë lekë, është shënuar një rritje prej 10,460 mijë lekësh, ose 30% më shumë. Nga totali i të ardhurave të realizuara për vitin 2024, 30% përbëhet nga arkëtimi i detyrimeve të prapambetura, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në mbledhjen e tyre.

Të ardhurat nga Tarifa e gjelbërimit 2023-2024



Tarifa për zënien e sipërfaqeve publike

Gjatë vitit 2024, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa për zënien e sipërfaqeve publike kanë arritur vlerën prej 12,948 mijë lekësh, duke tejkaluar ndjeshëm pritshmëritë. Në vitin 2023, të ardhurat nga kjo tarifë ishin 3,409 mijë lekë, ndërsa në vitin 2024 ato kanë realizuar 152% të planit vjetor, i cili ishte parashikuar në 8,500 mijë lekë. Krahësuar me vitin e kaluar, të ardhurat e arkëtuara janë rritur me 9,539 mijë lekë, ose 280% më shumë. Kjo rritje e konsiderueshme e të ardhurave ka ardhur si rezultat i shtimit të kërkesave nga ana e bizneseve për shfrytëzimin e hapësirave publike, veçanërisht nga subjektet që operojnë në sektorët e bareve, restoranteve, hotelierisë dhe aktiviteteve të ngjashme. Po ashtu, një ndikim pozitiv në performancën e kësaj tarife ka pasur edhe bashkëpunimi mes Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Shërbimeve, duke mundësuar një menaxhim më efikas dhe një mbledhje më efektive të të ardhurave.

Për vitin 2024, janë miratuar gjithsej:

- 53 leje ZHP për vendosjen e tavolinave në hapësira publike,
- 33 leje ZHP për aktivitete tregtare, duke përfshirë edhe tregtarët ambulante,
- 1 leje ZHP për organizimin e një spektakli.

Tarifa e Plazheve Private

Për vitin 2024, të ardhurat e realizuara kanë arritur vlerën prej 121,886 mijë lekësh, duke përfaqësuar 80% të planit vjetor. Kjo shifër është 15,585 mijë lekë më e lartë krahasuar me vitin 2023, ose 15% më shumë. Rritja e këtyre të ardhurave është rezultat i shtimit të aplikimeve në krahasim me vitin e kaluar.

Tabela 26: Realizimi i të ardhurave të veta të Bashkisë, viti 2024 (në mijë lekë)

NR.	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	FAKTI 2023	PLANI 2024	FAKTI 2024	Realizimi 2024 në %	Ndryshimi me 2023 në %
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA TË VITIT FISKAL (A1+A.2+A3+A4+A5)	1,851,571	2,344,450	2,303,708	98	24
A1	Të ardhurat nga taksat vendore	816,647	1,133,000	970,342	86	19
A.1.1	Taksë vendore mbi BV	4,426		4,821		9
a	Taksë e thjeshtuar mbi fitimin për BV	3,733		3,161		
b	Taksë e thjeshtuar mbi fitimin për BV (Debitor)	693		1,660		
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	331,375	532,000	515,238	97	55
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesat	294,387	450,000	444,463	99	51
a	Taksa mbi ndërtesat Biznesi	232,954	285,000	312,730	110	34
b	Taksa mbi ndërtesat Familje	61,433	165,000	131,733	80	114
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	9,031	45,000	15,638	35	73
a	Taksa mbi tokën bujqësore Biznesi	62	11,400			
b	Taksa mbi tokën bujqësore Familje	8,969	33,600	15,638	47	74



NR.	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	FAKTI 2023	PLANI 2024	FAKTI 2024	Realizi mi 2024 në %	Ndryshi mi me 2023 në %
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	27,957	37,000	55,137	149	97
a	Taksa mbi truallin Biznes	27,850	32,000	54,819	171	97
b	Taksa mbi truallin Familje	107	5,000	318	6	197
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurise					
A.1.3	Taksa vendore ne sherbimin ne hotel	65,391	65,000	152,921	235	134
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	369,440	460,000	235,868	51	-36
a	TNI nga Ndertimet e Reja (Leg. Aluizni)	22				
b	TNI nga Ndertimet e Reja	369,418	460,000	231.138	50	-37
A.1.5	Taksa e tabelës dhe reklames	18,470		4,730		
a	Taksa e tabelës për qellime identifikimi	9,130	31,000	27,233	88	47
b	Taksa e tabelës për qellime reklamimi	9,340	12,000	11,870	99	30
A.1.6	Taksa vendore mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotari vendore		19,000	15,363	81	64
A.1.7	Taksa te perkoheshme (arsimi)	27,545				
A.1.8	Taksa e perkoheshme 1		45,000	34,261	76	24
A.1.9	Taksa e perkoheshme 2					
A.2	Te ardhurat nga taksat e ndara (Grante)	310,670	315,050	330,062	105	6
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për P. paluajtshme	58,323	55,000	52,966	96	-9
A.2.2	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	174,943	190,000	190,446	100	9
A.2.3	Taksa e rentës minerare	21	50	21	42	0
A.2.4	Taksa mbi te ardhurat personale	77,383	70,000	86,629	124	12
A.2.5	Taksa te tjera					
A.3	Te ardhurat nga tarifat vendore	594,723	802,400	825,615	103	39
A.3.1	Nga tarifa per menaxhimin e mbetjeve	241,469	370,000	364,311	98	51
A.3.1.1	Nga familjet	71,920	160,000	141,548	88	97
A.3.1.2	Nga institucione					
A.3.1.3	Nga bizneset	169,549	210,000	222,763	106	31
A.3.2	Nga tarifa e pastrimit dhe largimit te mbetjeve					
A.3.3	Nga tarifa e ndricimit publik	65,105	78,000	104,088	133	60
A.3.3.1	Nga familjet	31,650	35,000	62,395	178	97
A.3.3.2	Nga institucione					
A.3.3.3	Nga bizneset	33,455	43,000	41,693	97	25
A.3.4	Nga tarifa e gjelberimit	57,436	56,000	85,834	153	49
A.3.4.1	Nga familjet	22,263	14,000	40,202	287	81
A.3.4.2	Nga institucione					
A.3.4.3	Nga bizneset	35,173	42,000	45,632	109	30

NR.	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	FAKTI 2023	PLANI 2024	FAKTI 2024	Realizimi 2024 në %	Ndryshimi me 2023 në %
A.3.5	Tarifa shërbimi nga administrata e bashkisë	183,866	250,980	219,114	87	19
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë					
A.3.5.2	Nga Tarifa për dhenie license, lejeve dhe autorizimeve	16,042	25,000	14,861	59	-7
A.3.5.3	Nga Tarifat të kontrollit dhe zhvillimit të territorit	1,259	5,000	1,630	33	29
A.3.5.4	Nga Tarifa për vulosje veterinare të bagetive të therura	280	400	280	70	0
A.3.5.5	Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit, autorizime	9,974	3,580	11,812	330	18
A.3.5.6	Nga Tarifa për parkimin të mjeteve të licensuare në vendparkime publike	28,460	37,000	35,024	95	23
A.3.5.7	Nga tarifa për dhenie license të tregtimit të naftës dhe nenprod.					
A.3.5.8	Nga tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.			1,596		
A.3.5.9	Nga tarifatat për shërbimet shtese të zjarrefikse MKZ	5,528	5,000	5,899	118	7
A.3.5.10	Nga tarifa për zënieën&perdorimin e hapësirave publike, fasada	122,323	175,000	148,012	85	21
A.3.5.10.1	Tarifa për zënieën e sipërfaqeve publike	3,409	8,500	12,948	152	280
a.	Tarifa për zënieën e sipërfaqeve publike për vep.ekonomike	3,096	5,000	5,815	116	88
b.	Tarifa për zënieën e sipërfaqeve publike tavolina	313	3,500	7,133	204	2178
A.3.5.10.2	Tarifa e Plazheve Private	106,301	151,500	121,886	80	15
A.3.5.10.3	Tarifa e Zënies së Hapësirave të Tregut Agrobujqësor	12,613	15,000	13,178	88	4
A.3.5.11	Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve në landfille					
A.3.5.12	Nga tarifa për linja ajrore & n/tokesore(telefon, energji, tvkabll, internet)					
A.3.5.13	Nga tarifa për dokumenta tender, ankand, etj.					
A.3.6	Tarifa për shërbimet nga instit.e vartesisë nga bashkia (arsimi, kultura, sporti etj)	46,847	47,420	52,268	110	12
A.3.6.1	Nga biblioteka					
A.3.6.2	Nga muzeumet					
A.3.6.3	Nga teatri	1,209	2,210	716	32	-41
A.3.6.4	Nga QK Femijeve			730		
A.3.6.5	Nga pallati I sportit	889	100	51	51	-94
A.3.6.6	Nga Q.Komunitare					
A.3.6.7	Nga konviktet	1,158	1,060	1,152	109	-1
A.3.6.8	Nga kopshtet	32,915	32,900	35,401	108	8

NR.	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	FAKTI 2023	PLANI 2024	FAKTI 2024	Realizimi mi 2024 në %	Ndryshimi mi me 2023 në %
A.3.6.9	Nga cerdhet	10,676	11,150	14,048	126	32
A.3.7	Tarifa për furnizimin me uje kanalizime					
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit					
A.3.9	Tarifa e perkoheshme					
A.3.10	Tarifa te tjera (Funerale)	-				
A4	Te ardhura te tjera	129,531	94,000	177,689	189	37
A.4.1	Qeraja nga asetet ne pronesi te bashkise	7,639	11,800	10,933	93	43
a.	Qeraja nga ndertesat	6,755	10,700	10,204	95	51
b.	Qeraja nga toka bujqesore	884	1,000	203	20	-77
c.	Qeraja nga troje	-	100	526		
A.4.1.1	Qeraja nga banesat sociale	28,052	32,200	29,226	91	4
A.4.2	Kthimi nga invstimet kapitale					
A.4.3	Fitimi nga Nd.Publike ne varesi te Bashkise					
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat					
A.4.5	Terheqe e te ardhurave te krijuara nga shërbimet					
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	93		458		392
A.4.7	Kundravajtjet administrative, gjobat	64,048	50,000	113,495	227	77
a.	Gjoha DTTV	24,456	25,000	60,218	241	146
b.	Gjoha Mjedis,KLSH,Pol.Bashkiake	10,800	25,000	32,665	131	202
c.	Gjoha Polici Bashkiake	24,871		14,356		-42
d	Gjoha MkZ					
e	Kamatvonesa	3,921		6,256		60
A.4.8	Sekuestrime dhe zhdemtime					
A.4.9	Kuotat e antaresise se Bashkive					
A.4.10	Transferta dhe ndihma nga njesite e tjera vendore					
A.4.11	Grante dhe ndihma nderkombetare/Donacione	1,220				
a	Sponsorizime nga OJF	1,220				
b	Sponsorizime nga subjekte shteterore dhe private					
A.4.12	Shitje e asetëve financiare					
A.4.13	Shitja e asetëve fikse te prekshme, te paprekshme					
A.4.14	Te tjera	28,479		23,577		-17
A.4.14.1	Tarifa vendore certificate perdorimi	27,776		20,914		-25
A.4.14.2	Tarife rregjistrimi per veprime te ndryshme(debitore)	143		326		128
A.4.14.3	Te ardhura te tjera te paklasifikuara	560		2,337		317
TOTALI		1,851,571	2,344,450	2,303,707	98	24

Raport mbi monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024



ANEKSI 1 "RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE"

Emri i Grupit		BASHKIA DURRËS				Kodi i Grupit	00	
Programet		në 000/lekë						
		(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	(2) PBA Viti 2024	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhës /progresiv 4 mujori III-të 2024	(6) Fakti i Periudhës/ progresiv 4 mujori III-të 2024	(7)=(6)-(5) Diferenca
Titulli	Emërtimi							
01110	Programi 1	494,937	505,395	505,395	736,624	703,715	621,080	-82,635
03140	Programi 2	75,694	111,073	111,073	112,359	97,359	78,784	-18,575
03280	Programi 3	65,892	143,216	143,216	163,676	129,055	84,450	-44,606
04130	Programi 4	919	3,430	3,430	9,741	9,295	4,250	-5,045
04220	Programi 5	0	0	0	20,316	20,316	0	-20,316
04240	Programi 6	95,425	73,422	73,422	94,206	82,206	71,278	-10,928
04260	Programi 7	2,615	3,819	3,819	7,060	7,060	3,703	-3,356
04520	Programi 8	387,723	427,121	427,121	574,187	451,560	367,390	-84,171
04570	Programi 9	0	0	0	0	0	0	0
05100	Programi 10	965,717	969,905	969,905	976,789	976,640	932,478	-44,162
06140	Programi 11	17,100	196,908	196,908	237,441	196,242	169,818	-26,424
06260	Programi 12	401,715	510,201	510,201	562,743	496,032	380,465	-115,567
06370	Programi 13	0	0	0	66,603	66,603	0	-66,603
07220	Programi 14	11,387	0	0	4,661	4,661	2,511	-2,150
08130	Programi 15	121,973	135,160	135,160	161,466	157,565	154,763	-2,802
08220	Programi 16	71,181	190,236	190,236	208,911	134,301	116,184	-18,117
09120	Programi 17	566,002	715,799	715,799	796,766	557,257	512,504	-44,753
09230	Programi 18	102,142	256,437	256,437	283,577	282,435	124,626	-157,809
10430	Programi 19	130,742	170,804	170,804	178,073	177,973	153,655	-24,317
10661	Programi 20	35,952	51,177	51,177	69,177	58,797	48,800	-9,997
Totali i Shpenzimeve të Njesisë		3,547,116	4,464,104	4,464,104	5,264,377	4,609,073	3,826,739	-782,335
	F. rezervë		35,000	35,000	52,384	20,000	-	-20,000
	F. kontigjencës		15,000	15,000	15,000	-	-	-
Totali		3,547,116	4,514,104	4,514,104	5,331,762	4,629,073	3,826,739	-802,335

Raport mbi monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024



ANEKSI 2 “RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS ARTIKUJVE”

Bashkia	DURRËS	Kodi i Grupit / Njësia Vendore											00
Programi	Të gjitha programet	Kodi i Programit											
Art.	Emërtimi	-1	-2	-3	-4	-5	Fakti	Diferenca					
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	PBA Plan Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ progresiv 4 mujori III-të 2024							
600	Paga	1,260,254	1,454,475	1,454,475	1,541,181	1,535,462	1,406,497	-128,966					
601	Sigurime Shoqërore	209,370	239,031	239,031	255,074	255,074	235,146	-19,929					
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,118,006	1,247,736	1,247,736	1,442,279	1,421,457	1,275,636	-145,821					
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0					
604	Transferta Korrente të Brendshme	40,000	20,000	20,000	46,064	46,102	46,064	-38					
605	Transferta Korrente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0					
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	76,917	93,500	93,500	99,950	91,669	89,998	-1,671					
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	2,704,547	3,054,742	3,054,742	3,384,548	3,349,765	3,053,340	-296,425					
230	Kapitale të Patrupëzuara	24,756	15,000	15,000	29,627	15,627	9,616	-6,011					
231	Kapitale të Trupëzuara	817,813	1,394,361	1,394,361	1,850,203	1,243,682	763,783	-479,899					
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0					
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	842,569	1,409,361	1,409,361	1,879,829	1,259,309	773,398	-485,910					
230	Kapitale të Patrupëzuara												
231	Kapitale të Trupëzuara												



ANEKSI 5 “PROJEKTET E INVESTIMEVE ME FINANCIM TË BRENDSHËM”

Në lekë

Nr.	Kod Programi	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Kap.	Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Vlera e kontratës	Financim 2023	Buxheti 2024	Planet e çelura	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
	01110					Planifikim , menaxhim dhe administrim	371,781,665			44,540,520	-	77,942,844	45,040,520	44,501,920	44,501,920
1	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071623	Blerje pajisje TIK për Bashkinë	7,000,000	2024	2024	2,879,280		7,000,000	2,879,280	2,879,280	2,879,280
2	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071624	Vendosje sistem kondicionimi dhe sistem konferencash për sallën e mbledhjes së Keshillit Bashkiak	3,500,000	2024	2024	3,405,120		3,500,000	3,405,120	3,405,120	3,405,120
3	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071625	Sistemi GPS dhe monitorim karburant për automjetet në pronësi të Bashkisë Durrës	4,800,000	2024	2024			4,800,000			-
4	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071626	Vendosje Monitor LED në Bashkinë Durrës	3,000,000	2024	2024	2,818,320		3,000,000	2,818,320	2,818,320	2,818,320
5	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071627	Rikonstrukcion i objekteve të Njësive Administrative nr.1,4,5, Sukth dhe Rrëshbull	113,536,946	2024	2025			23,000,000			-
6	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071628	Mbikqyrje objekti "Rikonstrukcion i objekteve të Njësive Administrative nr.1,4,5, Sukth dhe Rrëshbull"	1,504,666	2024	2025			705,044			-
7	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071629	Kolaudim objekti "Rikonstrukcion i objekteve të Njësive Administrative nr.1,4,5, Sukth dhe Rrëshbull"	145,613	2025	2025			-			-
8	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071630	Ndërtim godinat e N/A Ishëm , Manez, Katund i ri	235,719,000	2026	2026			-			-
9	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071631	Mbikqyrje objekti "Ndërtim godinave të Njësive Administrative Ishëm , Manez, Katund i Ri"	2,299,500	2026	2026			-			-
10	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071632	Kolaudim objekti "Ndërtim godinave të Njësive Administrative Ishëm , Manez, Katund i Ri"	275,940	2026	2026			-			-



Nr.	Kod Programi	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Kap.	Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Vlera e kontratës	Financim 2023	Buxheti 2024	Planet e çelura	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
11	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071061	Shitimi i funksionaliteteve të kontrollit dhe kualiteteve të taksave, vjeljes së detritit dhe menaxhimit me efikasitet të buxhetit fiskal në sistemin ekzistues të Bashkisë	40,000,000	2023	2024	35,437,800		35,437,800	35,437,800	34,945,600	
12	01110	Bashkia Durrës	231	5	1071724	Blerje pajisje multimediale	500,000					500,000	500,000	453,600	
	03140					Sherbimet e Policisë Vendore	15,000,000					15,000,000			
13	03140	Bashkia Durrës	231	5	1071723	FV kamera sigurie në hapësirat publike të qytetit Durrës	15,000,000	2024	2024						
	03280					Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	69,936,233			52,300,225	67,320,229	66,700,051	48,580,051	20,764,658	
14	03280	Bashkia Durrës	231	5	1071251	Perforcimi i terrenit nga rrethqija e dherave në lagjen nr.10 në kodër pranë Currlave nga ana veriore e perendimore e saj	12,936,233	2023	2024	10,320,229	10,120,178	200,051	200,051	10,120,178	
15	03280	Bashkia Durrës	231	5	1071633	Blerje automjetet zjarfikues për DREJTORIN E MZSH-se VKB NR.30 DT.06.03.2024	28,000,000	2024	2024	27,000,000		28,000,000	27,000,000		
16	03280	Bashkia Durrës	231	5	1071634	Blerje kamion me cisterne për transport lende të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-se VKB NR.30 DT.06.03.2024	16,500,000	2024	2024			16,500,000			
17	03280	Bashkia Durrës	231	5	1071635	Blerje automjetet i vogël zjarfikues (përkup)	12,500,000	2024	2024	11,880,000		12,500,000	11,880,000	10,644,480	
18	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071725	Pompa uji për MZSH	1,500,000	2023	2024			1,500,000	1,500,000		
19	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071726	Blerje pajisje TIK për MZSH	1,000,000	2023	2024			1,000,000	1,000,000		
20	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071758	Blerje pajisje elektroshtepiake për MZSH	400,000	2023	2024			400,000	400,000		
21	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071727	Sistemi i ambienteve të jashtme të godinës së MZSH	3,800,000	2023	2024	3,099,996		3,800,000	3,800,000		
22	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071728	Mobilim i ambienteve të brendshme të MZSH	2,000,000	2023	2024			2,000,000	2,000,000		
23	03280	Bashkia Durrës	231	1	1071729	Pompe luftuese zjarri agregat për mjet zjarfikues	800,000	2023	2024			800,000	800,000		
	04130					Mbeshtetje për zhvillimin ekonomik	16,311,111			9,344,354	-	6,311,111	6,311,111	1,311,111	

Raport mbi monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024



Nr.	Kod Programi	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Kap.	Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Vlera e kontratës	Financim 2023	Buxheti 2024	Planet e çelura	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në përfundim në periudhën aktuale	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në përfundim në periudhën aktuale
24	04130	Bashkia Durrës	231	5	1071532	Rindërtimi i Qendres Rmore Multifunkionale Durrës (vlera e plotë e projektit është 11,311,111 leke. Bashkia bashkëfinancoi 12% ose 1,311,111 leke, pjesa tjetër prej 10,000,000 leke bashkëfinancohet nga AKR)	11,311,111	2023	2024	9,344,354		1,311,111	1,311,111	1,311,111	1,311,111
25	04130	Bashkia Durrës	231	1	1071618	Platforme dixhitale për produktin "Karta e studentit"	5,000,000	2023	2024			5,000,000	5,000,000		-
	04220					Shtërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	20,316,320			227,087	-	20,316,320	20,316,320	-	-
26	04220	Bashkia Durrës	231	1	1071730	Ngritja e qendres për trajtimin e kafshëve të rrugës	20,000,000	2023	2024			20,000,000	20,000,000		-
27	04220	Bashkia Durrës	231	1	1071731	Mbakëgjyrie objekti : Ngritja e qendres për trajtimin e kafshëve të rrugës	282,429	2023	2024	227,087		282,429	282,429		-
28	04220	Bashkia Durrës	231	1	1071732	Kolaudim objekti : Ngritja e qendres për trajtimin e kafshëve të rrugës	33,891	2023	2024			33,891	33,891		-
	04240					Menaxhimi i infrastruktures së ujërave dhe kullimit	14,140,000			12,755,624	0	14,029,200	2,029,200	2,029,200	2,029,200
29	04240	Bashkia Durrës	230	5	1071535	Hartimi i planëve të gadishmërisë së emergjencave të digave, hartimi i pashaportave të digave dhe hartimi i projektpreventivave për rehabilitimin e digave	12,000,000	2023	2024	10,724,424		12,000,000			-
30	04240	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071622	Punime riparimi në puseten e komandimit rezervuarit Tapana	2,140,000	2023	2024	2,029,200		2,029,200	2,029,200	2,029,200	2,029,200
	04520					Rrjeti rrugor	347,165,440			440,889,890	109,840,767	451,930,840	329,303,573	254,947,094	364,787,861
						Ndërmarrja Rruga:	75,000,000			83,176,483	10,034,400	83,159,767	73,142,083	73,136,472	83,170,872
31	04520	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071636	Blerje Asfalto-beton	40,000,000	2024	2024	36,007,800		40,000,000	36,007,800	36,002,189	36,002,189
32	04520	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071637	Blerje materiale inerte	10,000,000	2024	2024	9,939,480		10,000,000	9,939,480	9,939,480	9,939,480
33	04520	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071638	Blerje beton	5,000,000	2024	2024	3,731,640		5,000,000	3,731,640	3,731,640	3,731,640

Nr.	Kod Programi	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Kap.	Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Vlera e kontratës	Financim 2023	Buxheti 2024	Planet e çelura	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
34	04520	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071639	Furnizim dhe vendosje sinjalistike rrugore	20,000,000	2024	2024	15,303,396		20,000,000	15,303,396	15,303,396	15,303,396
35	04520	Ndërmarrja Rruga	231	5	1071524	Furnizim dhe vendosje sinjalistike rrugore	22,000,000	2023	2024	18,194,167	10,034,400	8,159,767	8,159,767	8,159,767	18,194,167
						Bashkia :	272,165,440			357,713,407	99,806,367	368,771,073	256,161,490	181,810,622	281,616,989
36	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071558	Rehabilitim Rruga e Deshmorëve , segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo Uliqinaku tek Stacioni i Trenit.	60,500,000	2023	2024	48,041,775	6,964,800	41,076,975	41,076,975	34,841,460	41,806,260
37	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071559	Mbikqytje objekti "Rehabilitim Rruga e Deshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo Uliqinaku tek Stacioni i Trenit."	811,500	2023	2024	709,903		709,903	709,903	307,649	307,649
38	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071560	Kolaudim objekti "Rehabilitim Rruga e Deshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo Uliqinaku tek Stacioni i Trenit."	97,500	2024	2024			97,500	97,500		-
39	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071519	Shpronësime pasurisë së paluajtshme 8513DR-H6, 2/643 , Nuriqe Falli	4,967,903	2024	2024			4,967,903	4,965,544	4,965,544	4,965,544
40	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071619	Shpronësim i pasurive prone private që preken nga investimi publik me objekt "Rehabilitimi i infrastruktures së rrjetit të kullimit në zonën e Portomanoos -Kaneqe dhe sistemin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, faza e parë" (vlera e miratuar me VKB nr. 157 dt.18.10.2023)	18,986,134	2024	2024			18,986,134			-
41	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071640	Furnizim vendosje pajisjesh për parkimet në qytetin e Durrësit VKB NR.30 DT 06.03.2024	15,000,000	2024	2024			15,000,000			-
42	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071641	Rikonstruksion rruge në Njesinë Administrative Sukth	20,000,000	2024	2024	13,028,520		20,000,000	13,028,520	13,028,520	13,028,520
43	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071642	Mbikqytje objekti "Rikonstruksion rruge në Njesinë Administrative Sukth"	360,000	2024	2024	311,359		360,000			-



Nr.	Kod Programi	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Kap.	Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Vlera e kontratës	Financim 2023	Buxheti 2024	Planet e çelura	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
44	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071643	Kolaudim objekti "Rikostruksion rrugë në Njesin Administrative Suktin"	43,500	2024	2024			43,500		-	-
45	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071644	Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Manez	20,000,000	2024	2024	13,306,320		20,000,000	13,306,320	11,744,400	11,744,400
46	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071645	Mbikqytje objekti "Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Manez"	360,000	2024	2024	311,345		360,000		-	-
47	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071646	Kolaudim objekti "Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Manez"	43,500	2024	2024			43,500		-	-
48	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071647	Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Isheh	20,000,000	2024	2024	12,774,600		20,000,000	12,774,600	-	-
49	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071648	Mbikqytje objekti "Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Isheh"	360,000	2024	2024	265,985		360,000		-	-
50	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071649	Kolaudim objekti "Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Isheh"	43,500	2024	2024			43,500		-	-
51	04520	Bashkia Durrës	231	5	1071650	Rikostruksion rrugë në Njesinë Administrative Katund i Ri	20,000,000	2024	2024	19,998,288		20,000,000	19,998,288	12,507,120	12,507,120
